

“Mo.Na: Monumente në Natyrë”, rekomandohen një sërë masash menaxhimi që mund të ndihmojnë në arritjen e këtij qëllimi, të cilat parashtrohen si më poshtë:

- ▶ **Ulja, deri në eliminimin e ndërhyrjeve zhvillimore të mëtejshme në zonat bregdetare.**
- ▶ **Zbutja e ndotjes urbane dhe ajo e shkaktuar nga aktivitetet bujqësore në shkallë pellgu ujëmbledhës.**
- ▶ **Zbatimi i menaxhimit të shëndoshë të mbetjeve brenda kontekstit të ekonomisë qarkulluese.**
- ▶ **Eliminimi i aktiviteteve të peshkimit të paligjshëm dhe vendosja e një menaxhimi më të mirë të peshkimit në zona të zgjedhura detare të mbrojtura rreptësisht.**
- ▶ **Rivendosja e popullatave të grabitqarëve natyrorë detarë për të kontrolluar njëkohësisht speciet invazive vendase dhe jo-vendase.**
- ▶ **Kontrolli i ankorimeve, bazuar në metodat e ankorimeve të sigurta ekologjike, veçanërisht I atyre mbi shtretërit me bar deti dhe habitatet e tjera të ndjeshme biogjene.**
- ▶ **Rritja e njohurive mbi Oqeanet përmes programeve arsimore për rritjen e ndërgjegjësimit për diversitetin detar dhe rëndësinë e tij në ruajtjen e cilësisë së jetës dhe aftësisë ripërtëritëse natyrore ndaj ndryshimeve klimatike**

Në vend të një epilogu

Duke marrë parasysh fushën e përhapjes dhe tiparet e përbashkëta të rreziqeve mbi ekosistemet detare në të gjithë Mesdheun, rekomandimet e mësipërme janë të qenësishme për të gjitha rastet studimore pilot të projektit "Mo.Na" dhe më gjerë.

Kërkime shkencore të mëtejshme dhe më të detajuara janë të nevojshme për të thelluar të kuptuarit e këtyre ekosistemeve detare pak të studiuara. Gjithsesi hartat në shkallë të gjerë të habitateve detare, të bazuara në modele dhe inspektime në terren, pavarësisht disa kufizimeve, ofrojnë një pasqyrë të vlefshme për të theksuar rëndësinë dhe kërcënimet, të cilat zakonisht neglizhohen në proceset e planifikimit bregdetar.

▶ Още за проекта “Mo.Na”:
<https://www.monumentnature.com>

Fotografisë: Yiannis Isaaris | dizajni nga: electrick | Koordinatori: Astrolabe | Përkthimi nga anglishtja në shqip: Klodjana Gjata, Marsela Piyku DEMAJ


Kontakt:
Qendra Helene për Kërkimin
Detar, Drejtues Projekti :
Dr. Maria Salomidi
Adresa:
46.7 km Athens Sounio Rd., P.O. Box 712,
GR19013 Anavyssos, Greece
e-mail:
iosecretariat@hcmr.gr; msal@hcmr.gr
Faqe web: <http://io.hcmr.gr>
Fb: <https://www.facebook.com/instituteofoceanography/>

Interreg
Balkan-Mediterranean
Mo.Na

Projekt i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian
dhe Fondet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse

Trashëgimia natyrore nënujore

në Nesebar, Butrint
dhe ishullin e Santorinit
në kuadër të projektit “Mo.Na”.



Projekti Mo.Na: Monumente në Natyrë


hcmr
ΕΛΚΕΘΕ
INSTITUTI I
OQEOGRAFISË

Hyrje

Në kuadër të Projektit Mo.Na, u morën në shqyrtim llojet e Habitave Detare që rrethojnë site të rëndësishme historike dhe arkeologjike në Greqi, Shqipëri dhe Bullgari, me qëllim regjistrimin e pranisë dhe shpërndarjes së komponentëve detarë të rëndësishëm nga pikëpamja ekologjike, si dhe për të identifikuar presionet aktuale që mund të rrezikojnë Shërbimet e tyre ndaj Ekosistemit, të cilat janë tepër të vlefshme, por shpeshherë të perceptuara me vështirësi.

Tre raste studimore

Si raste studimore pilot, u morën tre zona bregdetare me interes të veçantë kulturor dhe mjedisor: Butrinti në Shqipëri, Nesebari në Bullgari dhe Kaldera e Santorinit në Greqi. Habitatet detare në gjendje kritike dhe biodiversiteti i tyre shoqërues u inspektuan dhe analizuan në mënyrë që të vlerësohej gjendja e tyre ekologjike dhe të prodhoheshin harta në shkallë të gjerë për habitatet detare.

Vlerësimi Ekologjik:

GJENDJA AKTUALE DHE PRESIONET

Të gjitha sítet paraqisnin tipare natyrore me rëndësi të lartë ruajtjeje, por edhe disa shenja degradimi të vogla deri në të konsiderueshme.



Shtretër të pasur *Cymodocea nodosa* të Kanalit të Vivarit

Laguna e Butrintit dhe brigjet në afërsi, Shqipëri

Mbi-kullotja e iriqit të detit, specie jo-vendase dhe lloje të ndryshme mbeturinash detare, u regjistruan në të gjithë zonën e studimit, ndërsa zhvillimi i pakontrolluar bregdetar, ankorimi i

pakontrolluar, peshkimi i paligjshëm i midhjeve (*Lithophaga lithophaga*) dhe prania e mjeteve të peshkimit të braktisura u zbuluan kryesisht në gjirin e Ksamilit dhe në brigjet detare në afërsi të tij. Ndotja organike / turbullira ishte veçanërisht e theksuar në Butrint, duke e kufizuar kufirin e poshtëm të makroflorës në vetëm disa metra thellësi. Gjithashtu u konfirmua nekroza masive e një popullete të madhe të raportuar të midhjes endemike mesdhetare *Pinna nobilis* që karakterizonte më parë livadhet *Cymodocea nodosa* në grykëderdhjen e Butrintit, duke ndjekur tendencën alarmuese të territorit më të gjerë të Mesdheut.



Pyje të harlisur algash në shkëmbinjtë e cekët shkëmborë të Nesebar dhe Ravda

Nesebar – Ravda, Bullgari

Edhe pse zona e studiuar paraqiti disa tregues të Statusit të Mirë Mjedisor duke treguar zbutjen në mënyrë të konsiderueshme të ndotjes gjatë dekadës së fundit, gjithsesi prania e zhvillimit të pakontrolluar bregdetar, mbeturina detare, pajisje peshkimi të braktisura, si dhe rritja e efektit pushtues të specieve jo-vendase të të kërmillit të detit Rapa (*Rapana venosa*), si rreziqe të vazhdueshme në këtë zonë.

Kaldera e Santorinit, Greqi

Ndërkohë që kjo zonë detare me veti të larta oligotrofe paraqet tregues të paktë të ndotjes organike, prezenca e specieve jo-vendase, shkëmbinjtë nënujorë të lëna djerrë për shkak të peshkimit pa kriter dhe ndërprerjes së ciklit ushqimor, mjetet e peshkimit të braktisura dhe vdekshmëria masive e *Pinna nobilis* u identifikuan si rreziqet më të përhapura dhe të rëndësishme. Ankorimi i pakontrolluar kryesisht në nivel vendor dhe vendosja arbitrare e ankorimeve të shumta jo-ekologjike, u identifikuan si



Aspekte të shkëmbinjve mezofotikë (koraligjenë) të Kalderës

rreziku më i dukshëm në livadhet me *Posidonia oceanica* të Kalderas.

Rreziku	Zona e studimit		
	Butrinti dhe brigjet në afërsi	Nesebar Ravdë	Kaldera e Santorinit
Ndërtimet bregdetare	↑	↑	↑
Specie jo-vendase	↑	↑	↑
Zhdukja e specieve / ndërprerja e ciklit ushqimor	↑	↑	↑
Shkatërrim i habitatit	↑	-	↑
Ndotje e bregdetit	↑	↓	↑
Mbeturina detare / mjete peshkimi të humbura - të braktisura	↑	-	↑

Identifikimi in-situ i rreziqeve antropogjene dhe tendencave të tyre (↑ në rritje, ↓ në ulje, – e qendrueshme)

Masa të rekomanduara për Menaxhimin

Mungesa e objektivave konkrete të ruajtjes dhe masave të menaxhimit ka çuar në degradim të konsiderueshëm të trashëgimisë natyrore detare së fundmi, madje edhe në zona me interes të veçantë ruajtjeje siç është rasti i zonave studimore pilot në projektin "Mo.Na".

Peizazhet kulturore bregdetare mund të shërbejnë si një pikë referimi e fuqishme për të ndjekur dhe përmirësuar mbrojtjen e mjedisit detar. Në këtë kuadër, harta e përditësuar e habitateve dhe vlerësimi i shëndetit ekologjik janë parakusht për çdo vendimmarrje të shëndoshë. Bazuar në një bazë të dhënash hapësinore të attributeve ekologjike të hartuar në kuadër të projektit Balkan-Med,